Pas njoftimit publik, në drejtorinë tonë janë paraqitur rastet, të cilat janë udhëzuar për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga MMPHI. Në muajin tetor është dorëzuar aplikacioni për të tre nënprojektet, ndërsa në muajin dhjetor është marrë zyrtarisht përgjigjja pozitive, ku MMPHI ka ndarë financimin në vlerë prej 2,640,000.00 euro.

Nga ky projekt do të përfitojnë familjet e cënueshme përmes tre nënprojekteve: ndërtimi i objektit të ri me banesa, rindërtimi dhe renovimi i

shtëpive.

Drejtoria, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera komunale përmes NJIP-it, do të punojë për implementimin e tre nënprojekteve.

SEKTORI I PLANIFIKIMIT

Hartimi i Hartës Zonale të Komunës

Aktualisht po punohet në draftin e Hartës Zonale të Komunës (HZK) dhe njëkohësisht po punohen hartat/pjesa grafike.

SEKTORI I NDËRTIMIT - MENAXHIMI I KONTRATAVE

- Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Elena Gjika" në Deçan
- Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut
- Ndërtimi i murit mbrojtës të Urës së Demës
- Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë-olimpike
- Zhvillimi i turizmit në Komunën e Deçanit – produktet turistike në fshatin alpin bjeshkatar – Zip Line
- Renovimi dhe mobilimi i sallës së kurorëzimit
- Ndërtimi dhe rikonstruimi i lapidareve të dëshmorëve

TAKIME

Takimi me Urbis për prezantimin e draftit të HZK te drejtorët komunalë

Data: 22.05.2025

Vendndodhja: Salla e katit të dytë të objektit të Komunës së Deçanit

Pjesëmarrës: Beqir Berisha, Fisnik Prenaj, Bashkim Ramosaj, Rame Melaj, Shkelzen Shehu, Blerta Gjocaj, Jashar Hulaj, Rifat Stojkaj, Edone Kameraj, Agron Muslija, Halil Tolaj, Isuf Demhasaj, Dafina Cacaj, Agnesa Vokshi, Besnik Hulaj.

Përmbajtja e takimit:

Në këtë takim u bë prezantimi i draftit të HZK dhe u diskutua rreth sfidave dhe mundësive për punën në hartimin e tij.

Takimi me Urbis për prezantimin e draftit të HZK te inxhinierët, arkitektët dhe investitorët

Data: 04.06.2025

Vendndodhja: Qendra Rinore

Pjesëmarrës: Beqir Berisha, Fisnik Prenaj, Bashkim Ramosaj, Rame Melaj, Shkelzen Shehu, Blerta Gjocaj, Ajshe Qorraj, Mirjete Bozhdaraj, Argjira Hadergjona, Zanfina Haxhosaj, Blerim Bajraktaraj, Leotrim Hadergjona, Trimor Gjokaj, Kreshnik Berisha, Hamid Dacaj.

Përmbajtja e takimit:

Në këtë takim u bë prezantimi i draftit të HZK dhe u diskutua rreth kërkesave të investitorëve dhe profesionistëve në fushën e ndërtimit, zhvillimit të qytetit, rrugëve etj.

Takimi i NJIP-it me përfaqësues të WBIF-it për Programin e Banimit Social Adekuat, dt. 27.08.2025

Takimi u mbajt në sallën e katit të dytë të komunës.

Të pranishëm ishin: Blerta Gjocaj, Mirjete Bozhdaraj, Donat Alaj, Thellenza Pula, Adelina Balidemaj dhe Irina Popescu.

Ekipi i WBIF-it ofroi mbështetje dhe udhëzime me qëllim që puna e NJIP-it të jetë sa më korrekte, si në raport me qytetarët ashtu edhe në respektimin e legjislacionit gjatë zbatimit të Programit të Banimit Social Adekuat.

➤ Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë për periudhën Janar – Dhjetor 2025, duke përfshirë kategoritë ekonomike të paga & mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjocat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar - Dhjetor të vitit 2025.

Buxheti i Komunës për vitin 2025, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2025, për komunën e Deçanit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

❖ Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,

❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetanake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,

1. TË HYRAT VETANAKE

1.1. Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale

Raporti i mëposhtëm mbulon vitin fiskal **2025** dhe paraqet informacionin e detajuar mbi **planifikimin dhe realizimin e të hyrave vetanake**, duke përfshirë edhe regjistrimin e mjeteve financiare.

- Për periudhën **janar–dhjetor 2025**, planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë **900,000.00 €**.
- Realizimi deri në **nëntor 2025** ka qenë **973,273.27 €**, që tregon një realizim mbi planin me një diferencë pozitive.

Të hyrat vetanake përfshijnë pagesa të ndryshme, përfshirë:

- gjoba nga trafiku dhe gjobat nga gjykata,
- tarifa dhe shërbime administrative të komunës,
- të tjera të ardhura të parapara nga rregulloret lokale.

Realizimi i të hyrave është raportuar sipas tremujorëve si më poshtë:

- **TM1 (Janar–Mars)** – tremujori i parë
- **TM2 (Prill–Qershor)** – tremujori i dytë
- **TM3 (Korrik–Shtator)** – tremujori i tretë

TM4 (Tetor–Dhjetor) – nuk është përfshirë ende, pasi raporti nga Thesari nuk është dërguar.

1.2. Tabelat e realizimit detaj të të hyrave vetanake

- *Raporti i realizimit të të hyrave financiare për periudhën Janar - Nëntor*

Të hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 1 vjeçare	
Janar	33,970.37
Shkurt	42,021.83
Mars	73,838.44
Prill	82,311.99
Maj	86,453.87
Qershor	99,525.63
Korrik	62,096.28
Gusht	121,477.33
Shtator	120,465.51
Tetor	84,736.46
Nëntor	32,668.56
Dhjetor	62,212.89
Totali	898,683.06

Raporti i realizimit të të hyrave financiare nga gjobat në trafik nga Policia dhe gjobat nga gjykatat për periudhën Janar – Shtator		
Të hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 9 mujore TM1, TM2 dhe TM3		
Muaji	Gjobat nga trafiku policia	Gjobat nga trafiku gjykata

Janar	11,936.00	300.00
Shkurt	14,130.00	1,050.00
Mars	15,005.00	1,810.00
Prill	13,810.00	600.00
Maj	15,500.00	2,300.00
Qershor	11,970.00	1,050.00
Korrik	14,021.00	820.00
Gusht	17,075.00	700.00
Shtator	10,950.00	830.00
Totali	124,397.00	9,460.00

Të hyrat vetanake: 898,683.06

Të hyrat nga gjobat në trafik dhe Gjykata: 133,857.00

Totali: 1,032,540.06 Euro

1.3.Paraqitja tabelare e periudhës së realizimit të të hyrave vetanake krahasuar me vitin 2024




Fig.1. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën janar–dhjetor 2024 - 2025

2. PLANIFIKIMI DHE SHPENZIMI I BUXHETI PËR VITIN 2025

2.1. Raport për periudhën janar–dhjetor 2025

Gjatë vitit 2025, Komuna e Deçanit ka menaxhuar buxhetin në përputhje me ligjet dhe rregulloret buxhetore, duke siguruar planifikim të kujdesshëm dhe shpenzim të rregullt të mjeteve publike.

2.1.1. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2026

Drejtorja për Buxhet dhe Financa gjatë muajit **qershor 2025** ka filluar procesin e planifikimit të buxhetit për vitin **2026**. Pas pranimit të **Qarkores së Parë Buxhetore 2026/2**, me datë **15.05.2025**, janë iniciuar takimet buxhetore për hartimin e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026–2028**.

Në kuadër të këtij procesi janë organizuar dhe mbajtur gjithsej **katër (4) dëgjime buxhetore**, përfshirë:

- dëgjim buxhetor me qytetarë dhe përfaqësues të këshillave lokale të fshatrave.

Me datë **28 qershor 2025**, **Korniza Afatmesme Buxhetore 2026–2028** është aprovuar nga **Asambleja Komunale**.

Pas lëshimit të **Qarkores së Dytë Buxhetore 2026/2** nga Ministria e Financave, me datë **15.08.2025**, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Ekzekutivin, KPF-në dhe Asamblenë Komunale, ka vazhduar me planifikimin e detajuar të buxhetit për vitin 2026.

Para finalizimit të planifikimit buxhetor, janë organizuar dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme të interesit, si në vijim:

1. Dëgjim buxhetor me sektorin e shëndetësisë
2. Dëgjim buxhetor me sektorin e arsimit
3. Dëgjim buxhetor me qytetarë dhe përfaqësues të fshatrave të Komunës së Deçanit
4. Dëgjim buxhetor me gratë
5. Dëgjim buxhetor me OJQ-të, rininë dhe sportistët

Në mbledhjen e Asamblesë Komunale të mbajtur më **28.09.2024**, është aprovuar **Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2025**.

2.1.2. Shpenzimi i Buxhetit për vitin 2025

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2025 ka qenë në shumën prej **13,501,365.00 €** nga **Granti Qeveritar**, si dhe **900,000.00 €** nga **Të Hyrat Vetanake**, të planifikuara për inkasim gjatë vitit 2025.

Si rrjedhojë, **buxheti fillestar total për vitin 2025** ka qenë **14,401,936.00 €**.

Të hyrat e bartura nga viti **2023 në vitin 2024** kanë qenë në shumën prej **184,532.24 €**.

Gjatë vitit 2025, numri i përgjithshëm i pagesave ka qenë **2,968**, ndërsa **2,192 pagesa** janë realizuar brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, që përfaqëson **73.85 %** të pagesave totale.

Me **Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/261**, datë **05.06.2025**, janë ndarë mjete buxhetore në kategorinë e pagave në shumën prej **319,594.29 €**, për rritjen prej **0.5 njësish të koeficientit**, e cila është aplikuar nga muaji korrik 2025.

Po ashtu, me **Vendimin Nr. 02/281**, datë **25.12.2025**, janë ndarë mjete shtesë në shumën prej **25,037.03 €**, për mbulimin e mungesës së mjeteve për pagat e muajit dhjetor 2025.

Tabela 1. Struktura e shpenzimeve për vitin 2025

Stafi	Paga dhe meditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Investime kapitale	Totali i buxhetit 2025
897	7,606,274.00	2,650,000.00	250,000.00	350,000.00	3,545,661.00	14,401,935.00

Tabela 2. Planifikimi i Buxhetit 2025 dhe Shpenzimi sipas Kategorive Ekonomike

PERSHKRIMI	BUXHETI FINAL	SHPENZIMI	DIFERENCA	SHPENZIMI NË %
GRANT QEVERITAR (10)	13,845,995.32	13,808,008.25	(37,987.07)	99.73%
PAGAT DHE SHTESAT	7,950,905.32	7,950,905.32	-	
MALLRA DHE SHERBIME	2,379,429.00	2,375,954.58	(3,474.42)	
SHPENZIME KOMUNALE	250,000.00	249,996.69	(3.31)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	290,000.00	289,708.79	(291.21)	
INVESTIMET KAPITALE	2,975,661.00	2,941,442.87	(34,218.13)	
TE HYRA VETANAKE (21)	900,571.00	889,768.31	(10,802.69)	98.80%
MALLRA DHE SHERBIME	270,571.00	260,521.00	(10,050.00)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	60,000.00	59,815.22	(184.78)	
INVESTIMET KAPITALE	570,000.00	569,432.09	(567.91)	
TE HYRA VETANAKE (22)	320,324.76	320,320.03	(4.73)	99.99%

MALLRA DHE SHERBIME	190,324.76	190,320.03	(4.73)	
SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	30,000.00	30,000.00	-	
INVESTIMET KAPITALE	100,000.00	100,000.00	-	
GRANT I DONAT.TË BRENDSHËM (31)	16,027.70	-	(16,027.70)	0
MALLRA DHE SHERBIME	4.00	-	(4.00)	
INVESTIMET KAPITALE	16,023.70	-	(16,023.70)	
GRANTE TJERA TË JASHTME (32)	974.50	-	(974.50)	0
MALLRA DHE SHERBIME	974.50	-	(974.50)	
QEVERIA NORVEGJEZE (57)	7.98	-	(7.98)	0
INVESTIMET KAPITALE	7.98	-	(7.98)	
QEVERIA JAPONEZE (59)	-	-	-	
INVESTIMET KAPITALE	-	-	-	
COUNCIL OF EUROPE (93)	43.65	-	(43.65)	0
MALLRA DHE SHERBIME	43.65	-	(43.65)	
TOTALI :GRANTI + THV+DONACIONET	15,083,944.91	15,018,096.59	(65,848.32)	99.56%

Tabela 3. Raporti i Shpenzimeve për periudhën janar–dhjetor 2025 sipas Kategorive Ekonomike

--	--

Përshkrim	Shuma
Valutë: EURO	
631 - GP+THV+THV nga viti i kaluar	15,018,096.59
11 - PAGA DHE SHTESA	7,950,905.32
13 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,826,795.61
14 - SHPENZIME KOMUNALE	249,909.57
20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	379,524.01
30 - PASURITË JOFINANCIARE	6,310,874.96
Bilanci i përgjithshëm	15,018,096.59

Tabela 3.1. Raporti i Shpenzimeve për periudhën janar–dhjetor 2025 sipas Fondit Burimor dhe Kategorive Ekonomike

Përshkrim	Shuma
Valutë Euro	
10 - GRANTI I PERGJITHSHEM	13,808,008.25
11 - PAGA DHE SHTESA	7,950,905.32
13 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,375,954.58
14 - SHPENZIME KOMUNALE	249,996.69
20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	289,708.79
30 - PASURITË JOFINANCIARE	2,941,442.87
21 - TË HYRAT VETANAKE	889,768.31
13 - MALLRA DHE SHËRBIME	260,521.00
20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	59,815.22
30 - PASURITË JOFINANCIARE	569,432.09
22 - TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	320,320.03
13 - MALLRA DHE SHËRBIME	190,320.03

20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	30,000.00
30 - PASURITË JOFINANCIARE	100,000.00
Bilanci i përgjithshëm	15,018,096.59

Buxheti i Komunës për vitin 2025 është menaxhuar në mënyrë të rregullt dhe transparente, duke respektuar procedurat ligjore dhe duke siguruar realizimin e detyrimeve ndaj stafit, qytetarëve dhe projekteve komunale. Raporti tregon një përdorim efektiv të fondeve, me respektimin e afateve ligjore për pagesa dhe transparencë në menaxhimin e mjeteve publike.

3. PAGESAT NË ARKË

3.1. Raport për periudhën janar – dhjetor 2025

Pagesat në arkë gjatë vitit **2025** janë realizuar për shërbime dhe taksa administrative me vlerë **nën 10 euro**, në përputhje me rregulloret financiare në fuqi. Këto pagesa kanë përfshirë shërbime të ndryshme administrative, si: certifikata të lindjes dhe ekstrakte të lindjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të vdekjes, certifikata të statusit martesor, certifikata të martesës, certifikata të bashkësisë familjare, certifikata të shtetësisë, vërtetime nga arkiva, si dhe taksa të tjera administrative.

Gjatë periudhës **janar–dhjetor 2025**, sipas raporteve zyrtare të arkës, janë evidentuar të dhënat financiare si në vijim: janë lëshuar fletëpagesa në vlerë totale prej **29,770 €**, ndërsa vlera e pagesave të anuluar ka qenë **768 €**. Mjetet financiare të grumbulluara dhe të dorëzuara në arkën kryesore kanë arritur shumën prej **35,619 €**.

Raport i fletëpagesave të lëshuara	29770 €
Raport i pagesave të anuluar	768 €
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	35619 €
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas kodit Ekonomik	R.S.27537 € - E.L.3460 € - G.K.1493 € - S.D.1329 €

Gjatë gjithë vitit raportues, në çdo ditë pune është realizuar barazimi i arkës në orët e mëngjesit, ndërsa në orët e pasdites është bërë zbrazja e arkës dhe dorëzimi i mjeteve financiare në postë, duke respektuar plotësisht procedurat dhe standardet financiare.

Në kuadër të punës së përditshme, janë pranuar pagesa për shërbime dhe taksa administrative të ndryshme, duke përfshirë pagesat për certifikata të lindjes dhe ekstrakte të lindjes, certifikata të tjera të gjendjes civile, taksa administrative, pagesa të kadastrës, aktvendime për regjistrimin e vdekjes, certifikata të martesës, taksa për verifikimin e dokumenteve, taksa rrugore, si dhe gjoba të ndryshme.

Ky raport dëshmon funksionimin e rregullt të arkës, transparencën në menaxhimin e mjeteve financiare dhe zbatimin korrekt të procedurave administrative gjatë vitit **2025**.

4. DEPARTAMENTI I TATIMIT NË PRONË

4.1. Raport për periudhën janar – dhjetor 2025

Departamenti i Tatimit në Pronë, gjatë periudhës **janar–dhjetor 2025**, ka realizuar aktivitetet e tij në përputhje me kompetencat ligjore dhe objektivat e përcaktuara, duke arritur rezultate të konsiderueshme në inkasim, administrim dhe përmirësim të të dhënave.

Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Tatimit në Pronë ka inkasuar nga tatimi në pronë shumën totale prej **520,053.85 €**.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave, janë trajtuar gjithsej **72 ankesa** për objekte dhe parcela, të cilat janë shqyrtuar nga komisioni përkatës dhe janë rregulluar në sistemin elektronik.

4.1.1. Aktivitetet kryesore të realizuara janë si vijon:

1. Është bërë barazimi i të dhënave financiare me Zyrën e të Hyrave për periudhën **janar–dhjetor 2025**.
2. Sipas raporteve të Zyrës së të Hyrave, me datë **26.12.2025**, të shkarkuara nga sistemi **Protax**, inkasimi i të hyrave për objekte dhe parcela për periudhën **janar–dhjetor 2025** ka arritur shumën prej **375,923.52 €**.
3. Janë realizuar gjithsej **125 regjistrime të reja** të pronave për vitin 2025.
4. Janë pranuar dhe trajtuar **118 kërkesa për korrigjim**.
5. Janë kryer **137 modifikime** të të dhënave të pronës përmes sistemit.
6. Janë realizuar **510 modifikime** të të dhënave të relacionit të tatimpaguesit përmes sistemit.
7. Janë bërë **1,887 modifikime** të të dhënave të tatimpaguesve.
8. Janë kryer **452 korrigjime manuale** të të dhënave.
9. Janë lëshuar gjithsej **297 certifikata**, bazuar në librin zyrtar të protokollit.
10. Janë nxjerrë vendime për shqyrtim në **shkallën e parë dhe të dytë** për ankesa pranë Departamentit të Tatimit në Pronë, për vitin **2024**.

Është bërë përmirësimi i të gjitha pagesave të dështuara dhe pagesave pa **Uniref**, të dërguara nga DTP-ja, në koordinim të vazhdueshëm me raportet e lëshuara nga Zyra e të Hyrave

➤ **Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Deçanit ushtron përgjegjësitë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke u fokusuar në planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve shëndetësore dhe të mirëqenies sociale në nivel lokal. Veprimtaria e Drejtorisë synon garantimin e shërbimeve cilësore, efikase dhe të qasshme për të gjithë qytetarët e komunës.

Gjatë vitit 2025, Drejtoria ka punuar në zhvillimin dhe zbatimin e programeve dhe iniciativave që kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit publik, forcimin e mbrojtjes sociale dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme. Në këtë drejtim, është realizuar bashkëpunim i vazhdueshëm me institucionet shëndetësore publike, organizatat sociale dhe partnerë të tjerë relevantë, me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe rritjes së efikasitetit të shërbimeve.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar identifikimit dhe mbështetjes së grupeve të cënueshme, përmes ndërhyrjeve të orientuara drejt nevojave konkrete dhe sigurimit të qasjes së barabartë në shërbime shëndetësore dhe sociale. Përmes këtyre veprimeve, Drejtoria ka synuar forcimin e përfshirjes sociale dhe uljen e pabarazive në komunitet.

Ky raport vjetor pasqyron aktivitetet kryesore, rezultatet e arritura si dhe sfidat e evidentuara gjatë vitit 2025. Njëkohësisht, raporti paraqet angazhimin institucional për përmirësim të vazhdueshëm dhe ndërtimin e kapaciteteve, duke krijuar bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore dhe sociale në Komunën e Deçanit

Misioni i Drejtorisë është:

- ✓ Sigurimi i shërbimeve shëndetësore cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të qasshme për të gjithë banorët e komunës;
- ✓ Mbrojtja e shtresave më vulnerabël të popullsisë përmes programeve të asistencës sociale;
- ✓ Zhvillimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për t'u përballur me nevojat shëndetësore dhe sociale të komunitetit.

Veprimtaria e Drejtorisë realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përfshirë Ligjin për Shëndetësi, Udhëzimet Administrative, Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Statusin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)

Vizioni:

Të transformojmë shërbimet sociale dhe shëndetësore përmes përmirësimit të cilësisë, menaxhimit efikas dhe bashkëpunimit institucional, në funksion të një jete më të shëndeteshme dhe më të sigurt për çdo qytetar, pa dallim.

OBJEKTIVAT KRYESORE PËR VITIN 2025

- Implementimi dhe institucionalizimi i kujdesit paliativ në nivelin parësor shëndetësor, përmes krijimit të njësive funksionale dhe koordinimit me QKMF-në dhe partnerët relevantë.

- Rritja e cilësisë dhe vazhdimësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale, me fokus në kujdesin e integruar për pacientët me sëmundje kronike dhe malinje.
- Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit shëndetësor dhe social, përmes trajnimeve të specializuara dhe standardizimit të shërbimeve.
- Përmirësimi i qasjes së barabartë në shërbime shëndetësore, veçanërisht për grupet e cënueshme dhe pacientët në nevojë për kujdes afatgjatë.
- Zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me organizata partnere, për mbështetje teknike, profesionale dhe financiare të projekteve shëndetësore, me theks të veçantë në kujdesin paliativ.
- Fuqizimi i rolit të Drejtorisë në planifikim, monitorim dhe menaxhim efikas të shërbimeve shëndetësore dhe sociale në nivel komunal.
- Identifikimi i nevojave sociale të familjeve me të ardhura të ulëta.
- Identifikimi dhe ndihma për personat që jetojnë në Shtëpinë e Komunitetit.
- Identifikimi i nevojave të stafit shëndetësor.

Drejtorja për Shëndetësi ka pasur si prioritet funksionalizimin e kujdesit paliativ, me qëllim që qytetarët e Komunës së Deçanit të kenë qasje më të lehtë, shërbime më cilësore dhe përkushtim më të afërt ndaj pacientëve në nevojë dhe familjarëve të tyre.

Një fokus i veçantë i këtij prioriteti ka qenë sigurimi i vazhdimësisë së shërbimit paliativ edhe gjatë ditëve të vikendit, duke garantuar mbështetje të pandërprerë për pacientët që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm shëndetësor dhe social.

Falë bashkëpunimit të ngushtë me organizatën AQH, si dhe përkrahjes së vazhdueshme të Kryetarit të Komunës, i cili ka mbështetur këtë iniciativë përmes sigurimit të pajisjeve të nevojshme mjekësore dhe logjistike, është arritur që ky projekt të **finalizohet** me sukses dhe të vihet në funksion të plotë.

Ky shërbim ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve paliativë, duke zvogëluar nevojën për referime jashtë komunës dhe duke forcuar besimin e qytetarëve në shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor. Drejtorja për Shëndetësi mbetet e përkushtuar që edhe në të ardhmen të avancojë dhe zgjerojë shërbimet paliative, përmes trajnimeve të stafit, rritjes së kapaciteteve profesionale dhe forcimit të bashkëpunimit me partnerë institucionalë dhe organizata mbështetëse.

DSHMS gjatë vitit 2025 ka pranuar 132 kërkesa, prej të cilave:

130 - Miratuar

2 - Refuzuar

0 - Pezulluar

0 - Anuluar

Aktivitetet dhe Bashkëpunimet e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Viti 2025

Gjatë vitit 2025, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Deçanit ka zhvilluar aktivitete dhe bashkëpunime, me fokus të veçantë në përmirësimin e qasjes në shërbime shëndetësore dhe sociale, forcimin e bashkëpunimit institucional, si dhe sigurimin e mbështetjes për kategoritë më të cënueshme të shoqërisë.

Aktivitetet Kryesore:

- Organizimi i takimeve të rregullta me qytetarët e Komunës së Deçanit, me qëllim të adresimit të kërkesave dhe shqetësimeve të tyre.
- Mbajtja e takimeve të vazhdueshme koordinuese me drejtorët e QKMF-së, SHK-së dhe QPS-së.
- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave individuale dhe kolektive nga qytetarët.
- Takime dhe bashkëpunime me organizata të ndryshme me karakter shëndetësor dhe social.
- Takime me donatorë vendorë dhe ndërkombëtarë për sigurimin e mbështetjes financiare dhe materiale.
- Takime dhe bashkëpunim me universitete të Republikës së Kosovës.
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës së personelit shëndetësor në QKMF dhe Shtëpinë e Komunitetit.
- Monitorimi i punës së personelit në Qendrën për Punë Sociale (QPS).
- Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve përmes rrugëve administrative.
- Zbatimi i planit të prokurimit dhe planifikimi i buxhetit vjetor.
- Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave të paraqitura nga QKMF, QPS dhe SHK.
- Identifikimi i nevojave sociale, familjare dhe komunitare, përfshirë nevojat në Shtëpinë e Komunitetit.
- Organizimi i sesioneve informuese në të gjitha shkollat fillore gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor, me fokus në informimin për vaksinën HPV.
- Dërgimi i kërkesës emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë për sigurimin e materialit esencial mjekësor Gaza Absorbent Cotton, Roll (Kod ATC-SHP22, Nr. rendor 173), për shkak të mungesës në institucionet shëndetësore komunale.
- Takim në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor lidhur me projektin për ndërtimin e banesave sociale.
- Organizimi i diskutimit publik për Statutin e QKMF-së.
- Planifikimi dhe përkrahja financiare për ZHVPS.
- Sigurimi i shërbimeve ambulatorë dhe ndihmës së parë mjekësore gjatë aktiviteteve sportive dhe kulturore.
- Takime me Ministrin dhe Sekretarin e Shëndetësisë për diskutim dhe përkrahje të projekteve të rëndësishme për shëndetësinë në Komunën e Deçanit.
- Takime me Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me kërkesat për barnat esenciale.
- Zhvillimi i fushatave informuese dhe parandaluese për shëndetin publik, me fokus në:
 - vaksinimin dhe imunizimin
 - parandalimin e sëmundjeve kronike,
 - ndërgjegjësimin për sëmundjet malinje,
 - promovimin e stilit të shëndetshëm të jetesës.

Marrëveshje dhe Bashkëpunime

- ***14 mars 2025 – Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe organizatës Action for Mothers and Children (AMC), me qëllim të përmirësimit të qasjes në kujdes shëndetësor për nënat dhe fëmijët.***
- ***29 prill 2025 – Ceremonia zyrtare e pranimit të donacionit nga Ambasada Japoneze në Kosovë, me fokus në pajisje shëndetësore dhe mbështetje teknike për institucionet komunale, si dhe paralajmërimi për donacione shtesë.***
- ***11 qershor 2025 – Takim bashkëpunimi me Spitalin Rajonal të Pejës, për forcimin e sistemit të referimit dhe koordinimin e shërbimeve shëndetësore.***
- ***Takim me Ministrin e Planifikimit Hapësinor për projektin e Banim Social dhe realizimi i marrëveshjes së nënshkruar nga Kryetari i Komunës.***
- ***Themelimi i Njesisë për Implementimin e Projektit për Banim Social.***
- ***Themelimi i Komisionit Vlerësues për shprehjen e interesit në kuadër të nënprojektit për renovim dhe rindërtim të shtëpive private për familjet dhe individët e cenueshëm.***
- ***17 korrik 2025 – Takim koordinues ndërinstitucional ndërmjet Komunës së Deçanit dhe Prokurorisë Themelore në Pejë.***
- ***Takim me organizatën AQH për diskutim mbi projektin e kujdesit paliativ në Komunën e Deçanit.***
- ***Marrëveshje në projektin “Realizimi i vizitave për pacientët me sëmundje kardilogjike” me Dr. Pasquale La Prova.***
- ***Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet DSHMS-së dhe KFOR-it Italian për realizimin e projektit të ndërtimit të ashensorit në QKMF Deçan, që mundëson qasje më të lehtë në katin e dytë.***
- ***Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me organizatën Accessible Quality Healthcare (AQH) për implementimin e projektit të kujdesit paliativ, me mbështetje nga Komuna e Deçanit dhe Ministria e Shëndetësisë.***
- ***Ministria e Shëndetësisë-Kryetari i Komunës së Deçanit (Mbështetje për dy projekte për QKMF , Deçan , Renovimi i Kulmit të QKMF-së dhe Pajisja me aparaturë moderne për laborator).***

Donacionet

- ***Donacion nga KFOR-i Italian, barna esenciale të shpërndara në QKMF dhe AMF-të sipas nevojave prioritare.***
- ***Pranimi i një autoambulance si donacion nga Kryetari i Komunës së Deçanit, z. Bashkim Ramosaj, për përmirësimin e shërbimeve emergjente.***
- ***Pranimi i donacioneve nga KFOR Italian – Regional Command West (CIMIC).***
- ***Pranimi i donacionit nga AQH në bashkëfinancim me Komunën e Deçanit për QKMF Deçan.***
- ***Komuna e Deçanit përfituese e projektit për Banim Social, që përfshin ndërtimin e njësive të reja të banimit social, renovimin dhe rindërtimin e shtëpive private për familjet dhe individët e cenueshëm.***
- ***Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet DSHMS-së dhe KFOR-it Italian për realizimin e projektit të ndërtimit të ashensorit në QKMF Deçan, që mundëson qasje më të lehtë në katin e dytë.***
- ***Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me organizatën Accessible Quality Healthcare (AQH) për implementimin e projektit të kujdesit paliativ, me mbështetje nga Komuna e Deçanit dhe Ministria e Shëndetësisë.***

- Pranimi të donacionit nga Ambasada Japoneze në Kosovë.
- Komuna e Deçanit përfituese e Projektit për Banim Social.

Procedurat e Prokurimit

- Gjatë këtij viti, janë ndjekur procedura të rregullta të prokurimit për pajisje, barna dhe shërbime të ndryshme, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.
- Procedurat janë realizuar në mënyrë transparente dhe në përputhje me planifikimin vjetor të Drejtorisë.

Në planifikimin e buxhetit DSHMS, në bashkëpunim me Qendrat e saj dhe duke identifikuar nevojat e qendrave ka inicuar këto procedura:

Furnizim më pajisje të IT-së **631-25-3517-5-5-8**

Furnizim më pajisje elektronike-printer për QKMF Adem Ukëhaxhaj-Deçan **631-25-4513-1-3-6**

Transporti dhe qëndrimi në Durrës për stafin e Shtëpisë së komunitetit **631-25-4929-2-3-6**

Furnizimi më reagensa të laboratorit 1 **631-25-6045-1-2-1**

Furnizim më reagensa të laboratorit 2 **631-25-7398-1-2-1**

INVESTIMET KAPITALE


EMRI I PROJEKTIT	STATUSI I REALIZIMIT
Furnizimi më pajisje medicinale	✓ Realizuar
Furnizimi me Klima (të pajisura të gjitha qendrat)	✓ Realizuar

<i>Furnizim më pajisje elektronike-printer për QKMF Adem Ukëhaxhaj-Deçan</i>	✓ Realizuar
<i>Furnizim më pajisje të IT-së</i>	✓ Realizuar

MALLËRA DHE SHËRBIME

EMRI I PROJEKTIT	STATUSI I REALIZIMIT
Furnizim me material administrativ për zyre për nevojat e shëndetësisë primare	✓ Realizuar
Furnizim më reagenca laboratorike	✓ Realizuar
Furnizim me material shpenzues sanitar dhe barna për nevojat e QKMF-së	✓ Realizuar
Servisim i pajisjeve laboratorike Dhe medicinale tjera	✓ Realizuar
Furnizim me material stomatologjik për nevojat e departamentit të stomatologjisë	✓ Realizuar
Furnizim me material higjieniko-sanitar për nevojat e shëndetësisë primare	✓ Realizuar
Mirëmbajtja e objekteve të shëndetësisë primare	✓ Realizuar
Mirëmbajtja e automjeteve	✓ Realizuar
Mirëmbajtja e pajisjeve	✓ Realizuar

Mirëmbajtja e rrjetit	✓ Realizuar
Furnizim për gjëra ushqimore për pacientët e Shtëpisë së Komunitetit	✓ Realizuar
Furnizim me derivate	✓ Realizuar
Sigurimi i objektit të shërbimeve rezidenciale	✓ Realizuar



Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Komunën e Deçanit

Vepron në përputhje me Legjislacionin në fuqi, përfshirë Ligjin për Shëndetësi, Udhëzimin Administrativ për Kujdesin parësor shëndetësor dhe Statutin e QKMF-së.

Në bazë të numrit të banorëve të kësaj komune, shëndetësia në Komunën e Deçanit operon si sistem i **KUJDESIT PARËSOR SHËNDETËSOR**, përmes një rrjeti funksional të institucioneve shëndetësore në zonën urbane dhe rurale.

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Deçanit, t'u ofroj shërbime shëndetësore gjithëpërfshirës dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuarët e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe, njëherit pikë referuese për specialistët konsultat në nivelet të tjera të kujdesit shëndetësor.

Sipas strategjisë së KPSH dhe standardeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë, ekipi i mjekësisë familjare i përbërë nga një **mjek familjar dhe dy infermiere familjare** ofron shërbime shëndetësore për **2000/2500** banorë sipas shtrirjes territoriale , gjeografike dhe organizimit të QKMF-së.

- **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)** - është një institucion shëndetësor publik që ofron shërbime shëndetësore dhe implementon Mjekësinë Familjare në Deçan.
- **Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF)** - funksionojnë në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet që kanë mbi 10.000 banorë.
- **Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)** - ofrojnë shërbime shëndetësore në vendbanimet nën 10.000 banorë.

SHËRBIMET në KPSH

- Vizitat mjekësore dhe shërbime në bazë të nevojave të pacienteve si: Dhënia e terapisë parenterale: Injeksione, infuzione, pastrim, fashim, inhalim.
- Shërbime Diagnostikuese: Analiza Laboratorike dhe Rentgen.
- Edukimi dhe promovimi shëndetësor: këshillim dhe promovim shëndetësor për pacientët me sëmundje kronike, për shëndetin oral, imunizim/vaksinim, konsulta për planifikim familjar.
- Vizita dhe shërbime për të moshuarit me sëmundje të rënda (kujdes paliativ).
- Kujdesin e vazhdueshëm për pacientët me sëmundje kronike jo-ngjitëse.
- Kujdes urgjent dhe kirurgji e vogël.
- Vaksinim dhe imunizim.
- Promovim i shëndetit oral dhe trajnimin bazik stomatologjik.
- Kujdes mjekësor në shtëpi (vizita në shtëpi në rastet urgjente, vizita dhe konsulta shtëpiake për nënat dhe fëmijët deri në tre vjeç).
- Sigurim të shërbimeve ambulantore dhe ndihmë mjekësore gjatë aktiviteteve sportive dhe kulturore.

Sektori i Shëndetit Publik

- ✓ Njësia e SISH-it
- ✓ Njësia e Imunizimit dhe Vaksinimit
- ✓ Sektori i Shëndetit Oral
- ✓ Sektori i Kujdesit Emergjent
- ✓ Sektori Konsultativ

- ✓ Njësia e Pediatriisë
- ✓ Njësia e Gjinekologjisë dhe Maternitetit
- ✓ Njësia e Dermatologjisë

Sektori i Diagnostikës

- ✓ Radiologjia
- ✓ Laboratori

Departamenti i Administratës

- ✓ Njësia apo zyra e personelit
- ✓ Njësia apo zyra Juridike
- ✓ Njësia apo zyra për Buxhet dhe Financa
- ✓ Njësia apo zyra për shërbime teknike

Qendrat dhe Ambulancat e Mjekësisë Familjare në Komunën e Deçanit

1. QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare) Strellc:

- 1.1.Njësia Mjekësisë Familjare.
- 1.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 1.3.Njësia e Laboratorit.

2. QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare) Isniq:

- 2.1.Njësia Mjekësisë Familjare.
- 2.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 2.3.Njësia e Laboratorit.

3. QMF (Qendra e Mjekësisë Familjare) Irzniq:

- 3.1.Njësia e Mjekësisë Familjare.
- 3.2.Njësia e Shëndetit Oral.
- 3.3.Njësia e Laboratorit.

4. AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Gramaçel:

4.1.Njësia e Mjekësisë familjare

5. *AMF (Ambulanca e Mjekësisë Familjare) Pobërgjë:*

5.1. Njësia e Mjekësisë Familjare

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Deçan funksionon sipas orarit në vijim:

Shërbimet në QKMF	Orari i punës
Mjekësia Familjare	7:00-22:00, 7 ditë në javë
Shërbimi Urgjent	7 ditë në javë, 24 h
Shërbimi Stomatologjik	7:00-14:00, 5 ditë në javë
Vaksinimi	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Laboratori hematologjik-biokimik	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Diagnostika	7:00-20:00, 5 ditë në javë
Barnatorja	7:00-22:00, 5 ditë në javë
Pediatra	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Gjinekologia	7:00-15:00, 5 ditë në javë
Këshillimorja	7:00-15:00, 5 ditë në javë
QMF dhe AMF	7:00-15:00, 5 ditë në javë

STAFI në QKMF

- *Mjekë familjarë: 7*
- *Mjekë të përgjithshëm: 15*

Totali mjekë për MF/urgjencë/pediatri: 21

- *Infermierë të MF: 64*
- *Mami: 7*
- *Mjekë konsultantë: 3*
- *Teknikë diagnostikë: 10*
- *Stomatologë: 55*
- *Asistentë stomatologjikë: 2*

Raporti i Vizitave dhe Shërbimeve Shëndetësore në QKMF

Mjekësia Familjare

Nr.	Muaj	Vizita e par	Udhëzimet	EKG	Triazhimi	Totali
1	Janar	3956	484	224	2901	7565
2	Shkurt	3773	507	161	3030	7471
3	Mars	3072	361	182	2855	6470
4	Prill	2659	359	133	2170	5321
5	Maj	2578	306	169	2064	5117
6	Qershor	2359	465	231	2146	5201
7	Korrik	2770	469	230	2831	6300
8	Gusht	5068	386	216	3341	9011
9	Shtator	3773	512	287	2785	7357
10	Tetor	3631	580	356	3116	7683
11	Nëntor	3785	437	210	2694	7126
12	Dhjetor	3534	324	184	2167	6209
13	Totali	40958	5190	2583	32100	80831

Mjekësia Familjare

Shërbimet	Totali	%
Vizita Mjekësor	40958	45.44%
Përshkrim i terapisë	0	0.00%

<i>Udhëzime</i>	<i>5190</i>	<i>7.14%</i>
<i>EKG</i>	<i>2353</i>	<i>3.24%</i>
<i>Triazhime</i>	<i>32100</i>	<i>44.18%</i>
		<i>0.00%</i>
Totali	80601	100.00%


Kujdesi emergjent

<i>Nr.</i>	<i>Muaj</i>	<i>Vizita e parë</i>	<i>Udhzi.</i>	<i>Ineksi- onet</i>	<i>Infuzi- onet</i>	<i>Inhal- imet</i>	<i>Ekg</i>	<i>P.plage.qepje</i>	<i>Viz. shtëpiake</i>	<i>Totali</i>
<i>1</i>	<i>Janar</i>	<i>4305</i>	<i>524</i>	<i>8555</i>	<i>3350</i>	<i>279</i>	<i>175</i>	<i>976</i>	<i>336</i>	<i>18500</i>
<i>2</i>	<i>Shkurt</i>	<i>2652</i>	<i>33</i>	<i>5638</i>	<i>2241</i>	<i>212</i>	<i>146</i>	<i>558</i>	<i>205</i>	<i>11685</i>
<i>3</i>	<i>Mars</i>	<i>2393</i>	<i>43</i>	<i>4342</i>	<i>1864</i>	<i>63</i>	<i>138</i>	<i>697</i>	<i>164</i>	<i>9704</i>
<i>4</i>	<i>Prill</i>	<i>2467</i>	<i>70</i>	<i>4090</i>	<i>1886</i>	<i>61</i>	<i>261</i>	<i>929</i>	<i>237</i>	<i>10001</i>
<i>5</i>	<i>Maj</i>	<i>2433</i>	<i>79</i>	<i>4154</i>	<i>1495</i>	<i>0</i>	<i>130</i>	<i>1038</i>	<i>233</i>	<i>9562</i>
<i>6</i>	<i>Qershor</i>	<i>2436</i>	<i>52</i>	<i>3291</i>	<i>1585</i>	<i>73</i>	<i>138</i>	<i>1244</i>	<i>189</i>	<i>9008</i>
<i>7</i>	<i>Korrik</i>	<i>2847</i>	<i>150</i>	<i>3704</i>	<i>2045</i>	<i>57</i>	<i>257</i>	<i>1285</i>	<i>246</i>	<i>10591</i>
<i>8</i>	<i>Gusht</i>	<i>3641</i>	<i>96</i>	<i>5113</i>	<i>3586</i>	<i>63</i>	<i>310</i>	<i>1270</i>	<i>279</i>	<i>14358</i>
<i>9</i>	<i>Shtator</i>	<i>2325</i>	<i>70</i>	<i>4105</i>	<i>1555</i>	<i>25</i>	<i>241</i>	<i>1282</i>	<i>306</i>	<i>9909</i>
<i>10</i>	<i>Tetor</i>	<i>2124</i>	<i>72</i>	<i>3904</i>	<i>1575</i>	<i>0</i>	<i>190</i>	<i>1051</i>	<i>252</i>	<i>9168</i>
<i>11</i>	<i>Nëntor</i>	<i>2047</i>	<i>77</i>	<i>4068</i>	<i>1855</i>	<i>71</i>	<i>337</i>	<i>981</i>	<i>286</i>	<i>9722</i>
<i>12</i>	<i>Dhjetor</i>	<i>1856</i>	<i>53</i>	<i>3851</i>	<i>1424</i>	<i>59</i>	<i>267</i>	<i>812</i>	<i>178</i>	<i>8500</i>
<i>13</i>	<i>Totali</i>	<i>31526</i>	<i>1319</i>	<i>54815</i>	<i>24461</i>	<i>963</i>	<i>2590</i>	<i>12123</i>	<i>2911</i>	<i>130708</i>

Kujdesi emergjent

<i>Shërbimet</i>	<i>Totali</i>	<i>%</i>
<i>Vizita Mjekësor</i>	<i>31526</i>	<i>24.12%</i>
	<i>0</i>	<i>0.00%</i>
<i>Udhëzime</i>	<i>1319</i>	<i>1.01%</i>

Ineksione	54815	41.94%
Infuzione	24461	18.71%
Inhalime	963	0.74%
EKG	2590	1.98%
Pastrim, qepje plage	12123	9.27%
	0	0.00%
	0	0.00%
Vizita Shtëpiake	2911	2.23%
	0	0.00%
	0	0.00%
		0.00%
Totali	130708	100.00%



- **Shërbimi Emergjent** përfaqëson komponentën më kritike të shërbimeve shëndetësore në QKMF, duke garantuar ndërhyrje të menjëhershme për raste akute, trauma, gjendje kërcënuese për jetën dhe situata emergjente mjekësore. Kjo njësi funksionon në koordinim të drejtpërdrejtë me Mjekësinë Familjare dhe institucionet e nivelit sekondar.
- **Analiza vjetore e të dhënave**

Gjatë vitit 2025 është evidentuar një fluks i lartë dhe konstant i rasteve emergjente, që përfshin vizita urgjente, ndërhyrje të menjëhershme, stabilizim të pacientëve dhe referime për trajtim të mëtejshëm. Numri i rasteve dëshmon për besimin e qytetarëve në shërbimin emergjent lokal dhe për rëndësinë e tij në ruajtjen e jetës dhe stabilizimin e gjendjes shëndetësore.

➤ **Fluksi dhe trendet mujore**


- ✓ Rritje e ndjeshme e rasteve gjatë sezonit veror, e lidhur me aksidente, trauma dhe ngarkesë sezonale.
- ✓ Rritje e rasteve respiratore dhe kardiovaskulare gjatë muajve dimërorë.
- ✓ Fluks i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, pa rënie të ndjeshme, që tregon nevojë permanente për gatishmëri.

➤ **PEDIATRIA**

Nr.	Muaj	Vizita e par	Ultrazëra	Udhëzim	Triazhi	Totali
1	Janar	849	47	184	692	1772
2	Shkurt	688	42	164	596	1490
3	Mars	438	46	34	400	918
4	Prill	471	45	35	386	937
5	Maj	323	31	21	240	615
6	Qershor	422	37	22	363	844
7	Korrik	601	69	39	388	1097
8	Gusht	692	55	36	496	1279
9	Shtator	299	45	14	274	632
10	Tetor	532	71	33	468	1104
11	Nëntor	498	57	37	408	1000
12	Dhjetor	451	46	28	357	882
13	Totali	6264	591	647	5068	12570

Ambulanca pediatrike		
Shërbimet	Totali	%
Vizita Mjekësor	6264	49.83%

		0.00%
Udhëzime	647	5.15%
	0	0.00%
Triazhime	5068	40.32%
Ultrazëri	591	4.70%
Totali	12570	100.00%



➔ **Shërbimi Pediatrik** ofron shërbime të specializuara për fëmijët, duke përfshirë ekzaminime, trajtime, ndjekje zhvillimore dhe këshillim prindëror. Ajo luan rol të rëndësishëm në parandalim dhe diagnostikim të hershëm.

➔ **Analiza vjetore e të dhënave**

Gjatë vitit 2025, Pediatria ka shënuar numër të konsiderueshëm vizitash, kryesisht për infeksione respiratore, sëmundje virale, çrregullime gastrointestinale dhe ndjekje rutinore të shëndetit të fëmijëve.


➔ **Fluksi dhe trendet mujore**

- ✓ Kulm i vizitave gjatë dimrit dhe fillimit të pranverës.
- ✓ Fluks i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit për vizita kontrolluese.
- ✓ Rritje e kërkesës për shërbime parandaluese dhe këshillimore

➤ **Dermatologjia**

Nr.	Muaj	Vizita e parë	Udhëzimet	Totali
1	Janar	120		120
2	Shkurt	204	4	208
3	Mars	194	7	201
4	Prill	140	8	148
5	Maj	149	7	156
6	Qershor	144	2	146
7	Korrik	152	8	160
8	Gusht			0
9	Shtator	131	10	141
10	Tetor	173	7	180
11	Nëntor	121	4	125
12	Dhjetor	194	5	199
13	Totali	1722	62	1784

Ambulanca Dermatologjike		
Shërbimet	Totali	%
Vizita Mjekësor	1722	96.52%
	0	0.00%
Udhëzime	62	3.48%
Totali	1784	100.00%



- ***Shërbimi I Dermatologjisë*** në QKMF ofron kujdes të specializuar për diagnostikimin, trajtimin dhe ndjekjen e sëmundjeve të lëkurës, indeve të buta dhe patologjive alergjike. Ky shërbim ka rol të rëndësishëm në trajtimin ambulator, parandalimin e komplikimeve dhe uljen e referimeve të panevojshme në nivelin sekondar.
- ***Analiza vjetore e të dhënave***

Gjatë vitit 2025, Dermatologjia ka realizuar një numër të konsiderueshëm vizitash dermatologjike, duke reflektuar kërkesë reale dhe të qëndrueshme nga popullata. Rastet më të shpeshta kanë përfshirë:

- ✓ dermatite alergjike dhe kontaktuese
- ✓ infeksione bakteriale dhe fungale të lëkurës
- ✓ sëmundje inflamatorë kronike (psoriazë, ekzema)
- ✓ çrregullime pigmentare dhe patologji të flokëve

Volumi i shërbimeve tregon se Dermatologjia është një njësi funksionale dhe e nevojshme në kuadër të kujdesit parësor të specializuar.


➤ ***Fluksi dhe trendet mujore***

- ✓ Rritje e dukshme e vizitave gjatë muajve pranverorë dhe verorë, e lidhur me ekspozimin ndaj diellit, alergjitë sezonale dhe infeksionet e lëkurës.
- ✓ Fluks i qëndrueshëm gjatë gjithë vitit për rastet kronike që kërkojnë ndjekje periodike.
- ✓ Stabilitet në shërbime, pa luhatje ekstreme, që dëshmon planifikim të mirë të kapaciteteve.

➤ **Gjinekologjia**

Nr.	Muaj	Vizita e pare	Ultrazë	Udhëzim	IM	IV	Totali
1	Janar	321	260	6	139	55	781
2	Shkurt	276	176	39	135	61	687
3	Mars	318	184	12	139	37	690
4	Prill	260	173	42	89	35	599
5	Maj	236	112	11	140	23	522
6	Qershor	211	100	14	147	27	499
7	Korrik	424	300	22	176	35	957
8	Gusht	282	200	26	210	29	747
9	Shtator	426	380	25	223	19	1073
10	Tetor	518	400	31	241	31	1221
11	Nëntor	308	290	20	122	45	785
12	Dhjetor	273	246	15	185	38	757
13	Totali	3853	2821	263	1946	435	9318

Ambulanca Gjinekologjike		
Shërbimet	Totali	%
Vizita Mjekësor	3853	41.35%
	0	0.00%
Udhëzime	263	2.82%
Ineksione	1946	20.88%
Infuzione	435	4.67%
Ultrazë	2821	30.27%
	0	0.00%
Totali	9318	100.00%



- **Shërbimi i Gjinekologjisë** ofron kujdes për shëndetin e gruas, përfshirë kontrolle rutinore, ndjekje të shtatzënisë, konsultime dhe trajtime specifike.
- **Analiza vjetore e të dhënave**

Gjatë vitit 2025, është evidentuar një fluks i qëndrueshëm i pacienteve, me fokus në kontrolle parandaluese dhe monitorim të shtatzënisë.


➤ **Fluksi dhe trendet mujore**

- ✓ Shpërndarje relativisht e barabartë mujore.
- ✓ Rritje e vizitave për kontrolle preventive.

➤ **Spektori i vaksinimit**

Nr.	Muaj	Vizita e pare	Vaksina	Totali
1	Janar	210	507	717
2	Shkurt	923	2428	3351
3	Mars	230	673	903
4	Prill	501	1033	1534
5	Maj	213	914	1127
6	Qershor	270	510	780
7	Korrik	160	478	638
8	Gusht	202	485	687
9	Shtator	192	555	747
10	Tetor	940	1296	2236
11	Nëntor	415	977	1392
12	Dhjetor	394	738	1132
13	Totali	4650	10594	15244

Spektori I vaksinimit		
Shërbimet	Totali	%
Vizita Mjekësor	4650	30.50%
	0	0.00%



<i>Vakcina</i>	<i>10594</i>	<i>69.50%</i>
<i>Totali</i>	<i>15244</i>	<i>100.00%</i>

- **SHËRBIMI I VAKSINIMIT** realizon imunizimin e popullatës sipas kalendarit kombëtar, duke luajtur rol kyç në parandalimin e sëmundjeve infektive.

Gjatë vitit 2025 është realizuar numër i konsiderueshëm i vaksinimeve, duke mbuluar grup mosha të ndryshme dhe doza të rregullta.

Janë realizuar mbledhje të rregullta me drejtorët e shkollave dhe takime me MASHTI-n, ku të gjitha detyrat e dhëna janë përmbushur me sukses.

Struktura organizative e DKA-së

DKA përbëhet nga 8 punëtorë kryesorë:

1. Drejtori
2. Udhëheqës i Sektorit Administrativ
3. Udhëheqës i Sektorit për Arsim
4. Përgjegjëse për Buxhet dhe Financa
5. Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë
6. Zyrtar Ligjor
7. Zyrtar për Arsimin Fillor
8. Zyrtar i Lartë Administrativ

Institucionet arsimore nën menaxhim

- **Numri i objekteve shkollore parauniversitare:** 20
- **Institucione parashkollore:** 2 (1 publik, 1 privat); një institucion publik është në ndërtim në hapësirën e SHFMU “Lidhja e Prizrenit”
- **Shkolla fillore dhe të mesme të ultë:** 18
- **Shkolla të mesme të larta:** 2

Stafi arsimor dhe nxënësit:

- Punonjës total: 574
 - Mësimdhënës: 420
 - Punonjës administrativ: 33
 - Punonjës teknik: 85

- Nxënës: 4.416

Infrastrukturë dhe pajisje

- Asnjë institucion arsimor nuk është i pajisur me sisteme të energjisë solare ose gjeotermale.
- **Institucione të pajisura me masa për kursimin e energjisë: 17**
- **Institucione me rrethoja të objekteve: 20**
- **Institucione që kanë dorëzuar raport përmbledhës 2 herë në vit: 19**
- **Institucione të pajisura me kamera sigurie: 19**
- **Institucione me sallë edukate fizike: 10**
- **Institucione me kabinete (laboratore/punëtori): 6**
- **Institucione me bibliotekë funksionale: 15**
- **Institucione me kabinete TIK funksionale: 18**
- **Objekte me klasa të pajisura me orendi të domosdoshme: 20**
- **Institucione me të paktën një klasë të pajisur me orendi dhe pajisje shkollore: 12**

Rezultatet arsimore

- **Testi i arritshmërisë për klasën e 9-të (2024/2025): 47,94%**
 - Vajzat: 45,71%
- **Nxënës që kanë përfunduar klasën e 12-të: 294**
 - Nxënëse: 140
- **Nxënës me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në maturën shtetërore (klasa 12): 239**
 - Vajza: 133

Orët mësimore

- **Numri total i orëve të planifikuara sipas kalendarit shkollor: 288.142**
- **Numri total i orëve të realizuara: 278.957**

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara:

- Janë mbajtur mbledhje të rregullta dhe takime ditore e javore me drejtorët e institucioneve shkollore. Në këto takime është kërkuar angazhim më i madh i mësimitdhënësve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektimin e ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.

- Mbledhje të rregullta janë zhvilluar edhe me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave ka treguar rezultate të shkëlqyera dhe të mira, si nga vlerësimi i brendshëm (DKA), ashtu edhe nga vlerësimi i jashtëm.
- Pranimi i raporteve të rregullta ditore, javore, mujore dhe vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave është kryer me interesim dhe angazhim të lartë nga të gjithë aktorët (personeli arsimor, prindërit, nxënësit, stafi mbështetës etj.).
- Është realizuar studimi i shpejtë (rapid) i të gjitha shkollave për identifikimin e pikave të dobëta, që shërbejnë si input për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal.
- Ka pasur përmirësim të cilësisë së arsimit dhe krijim të kushteve më të mira për nxënës dhe personel.
- Komuna e Deçanit renditet ndër komunat më të suksesshme në vend në rezultate shkollore, gara komunale dhe ato mbarëkombëtare.
- DKA është vlerësuar nga SIA-MASHTI për zbatueshmërinë e normativit dhe fondit të orëve, duke u renditur në krye të komunave të Kosovës.
- DKA është gjithashtu vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve për suksesin e lartë të arritur.
- Mbikëqyrja në institucionet arsimore është realizuar sipas objektivave të paraparë, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.
- Janë përgatitur dhe organizuar testet: e arritshmërisë, maturës shtetërore 2025, PIRLS, TIMSS dhe PISA për nxënës të moshës 15 vjeç.
- Janë planifikuar dhe zbatuar fondet e orëve për klasat me kurrikulën e re, duke respektuar udhëzuesin për ndarjen e orëve me zgjedhje.
- Sa i përket realizimit të fondit të orëve dhe procedurave rekrutuese sipas SIA-MASHTI (regjioni i Pejës), DKA Deçan udhëheq në të gjitha komunat e regjionit.
- Janë organizuar gara komunale në matematikë, fizikë dhe kimi, në bashkëpunim me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Janë mbajtur ligjërata nga Policia e Kosovës për parandalimin e dukurive negative tek nxënësit dhe të rinjtë, çdo muaj dhe sipas grupeve të fokusuara.
- Janë publikuar konkurset dhe është realizuar regjistrimi i fëmijëve në institucionet arsimore parashkollore dhe në klasën e parë.
- Janë vazhduar trajnime me grupe mësimdhënësish në bashkëpunim me organizatën “Lions Club Peja”.
- Drejtori i DKA-së ka zhvilluar takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme për mbështetje dhe avancim të procesit mësimor dhe reformave në arsim: ekspertë nga BE, Fakulteti i Edukimit, GIZ, Instituti Pedagogjik i Kosovës, KOSED, KFOR, Lions Club Peja, Down Syndrome Kosova, OJQ “Jeta” etj.
- Janë zhvilluar takime informuese me zyrtarët e MASHTI-t dhe mësimdhënës të niveleve të ndryshme për përmirësimin e teksteve shkollore.
- Janë futur të dhëna statistikore për nxënës dhe personel në sistemin EMIS-MASHTI.
- Integrimi dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta është bërë në mënyrë të vazhdueshme.
- Në fushën e psikologjisë, janë mbajtur punëtori për vetëdijesimin e nxënësve mbi dukuritë negative dhe tema të tjera të rëndësishme: bullizmi, përdorimi i narkotikëve, dhuna në familje, siguria në internet, parandalimi i ngacmimeve seksuale, respektimi i diversitetit, siguria rrugore dhe ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore.
- Bashkëpunim me asistentët e FAMNV për ndihmë në procesin e mësimin dhe hartimin e PIA për mësimdhënës që nuk kishin përvojë.
- Trajtim psikologjik për rastet që kishin nevojë, përfshirë familjet, institucionet arsimore dhe QPS.
- Janë organizuar punëtori dhe takime për detyrat dhe vështirësitë e asistentëve për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta, të udhëhequra nga koordinatori Ramiz Bajramaj dhe psikologët Besarta Idrizi dhe Florenta Molliqaj.

- Për nder të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, Drejtori i Arsimit shpërndau mirënjohje për mësime të mësuesit të komunës.
- Çmimi “Shaban Jashari” dhe mirënjohje janë dhënë për mësime të mësuesit të përkushtuar, duke përfshirë z. Ahmet Ukaj nga SHFMU “Faik Konica” në Ratishë.
- U organizua trajnim për 38 mësime të mësuesit mbi zbatimin e kurrikulës së re, i udhëhequr nga Dr. Hysen Balaj, ku Drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, inkurajoi mësime të mësuesit për praktikimin e njohurive të fituara.
- Ekipi komunal për parandalimin e braktisjes së shkollës ka trajtuar rastet me tendencë braktisjeje.
- Është hartuar Plani Zhvillimor i Arsimit Komunal nga ekspertë të shkollave dhe Prof. Dr.sc Ramë Likaj.
- Në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit të Komunës është organizuar Festa e Abetares për të gjitha shkollat.
- Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë bëhet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.09/2023, duke marrë vendim pas vlerësimit të nxënësve.
- DKA ka marrë pjesë në manifestime të Ditës së Shkollës në disa shkolla.
- Bashkëpunim me zyrën e Kryetarit për takime informuese mbi Planin Zhvillimor të Arsimit Komunal 2024-2027 dhe strategjinë e shkollave.
- Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të mësime të mësuesit për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore, të akredituara nga MASHTI dhe organizuar nga KOSED dhe IPK-ja, ku analizohen dhe rishikohen tekstet:
 - Shoqëria dhe mjedisi – Klasa 2 dhe 3
 - Histori – Klasa 9
 - Gjeografi – Klasa 9
 - Edukatë qytetare – Klasa 9
- U mbajt Testi i Arritshmërisë për klasat e nënta në tre qendra testimi (SHFMU “Lidhja e Prizrenit”), ku morën pjesë 370 nxënës dhe nuk u evidentuan parregullsi.
- Vizita të vazhdueshme monitoruese dhe mentoruese nga zyrtarët e DKA-së.
- Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnaz dhe IAAP.
- **Përfundimi me sukses i Pjesës së Parë të Provimit të Maturës Shtetërore**
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), organizoi me sukses pjesën e parë të Provimit të Maturës Shtetërore, duke vlerësuar lart organizimin dhe administrimin e këtij procesi të rëndësishëm arsimor.
Provimi u zhvillua në dy qendra testimi: Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” dhe IAAP “Tafil Kasumaj”, ku maturantët u sistemuan në 19 salla.
- **Debati Publik për Projekt-Buxhetin 2025/27 – Granti për Arsim**
Debati u kryesua nga Kryesuesi z. Hajdar Sutaj, me pjesëmarrjen e drejtores së Buxhetit dhe Financave znj. Dafina Cacaj, drejtorit për Arsim z. Besnik Hulaj, drejtorëve të shkollave dhe zyrtarëve komunalë.
Znj. Cacaj prezantoi ndarjen e buxhetit për sektorin e arsimit dhe dha sqarimet e nevojshme lidhur me këtë çështje. Drejtorët e shkollave paraqitën kërkesat dhe nevojat e tyre për projektbuxhetin e vitit 2025/2027. Diskutimet ishin kryesisht të përgjithshme, me pyetje dhe sugjerime të drejtuara nga drejtori Hulaj dhe znj. Cacaj, të cilët u përgjigjën mbi prioritetet për investime në shkolla.
- **Përfundimi me sukses i Pjesës së Dytë të Provimit të Maturës Shtetërore**
Pjesa e dytë e Provimit u organizua me sukses në një qendër testimi, IAAP “Tafil Kasumaj”, ku maturantët u sistemuan në 6 salla.

- **Përurimi i shkollës së re “Lan Selimi” në Lumbardh**

Më 1 Shtator 2025, u përurua shkolla e re “Lan Selimi” në Lumbardh. Shiritin e prerë përuruan familjari i Lan Selimit, ministresha e Arsimit znj. Arberie Nagavci dhe drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj.

- **Vizita në shkollë dhe takime me përfaqësues të Shoqatës Down Syndrome Kosova**

- Ekipa Mbështetëse Psikologjike-Pedagogjike vizitoi shkollën të ndryshme.

- U zhvillua një takim me znj. Grenita Grazhda nga Shoqata Down Syndrome Kosova – dega në Prizren, zyrtarin e DKA-së Ramiz Bajramaj dhe psikologët znj. Besarta Tahirukaj-Idrizi dhe Edita Tahirsylaj. Gjatë takimit u diskutua puna e Komisionit Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, sfidat gjatë punës dhe nevojat për trajnim dhe seminare për asistentët.

- **Komisioni Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore**

Komisioni filloi punën në vlerësimin dhe rivlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, në përputhje me U A MASHTI nr. 16/2017 dhe 02/2024.

- **Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën “Teach For Kosova”**

DKA nënshkroi marrëveshje për projektin “Let Girls Thrive”, i cili do të realizohet në SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Deçan.

- **Çertifikimi i 70 mësimdhënësve**

Në Sallën e Asamblesë Komunale u ndanë çertifikata për 70 mësimdhënës deçanas që përfunduan trajnime mbi “Të mësuarit logjik, kritik dhe krijues në mësimdhënie” dhe temat e tjera profesionale. Çertifikatat u ndanë nga Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, Koordinator Komunal z. Zeqë Malaj dhe trajnerët Dr.sc. Hysen Balaj dhe Msc. Burim Avdiaj.

- **Takime dhe mbështetje për asistentët dhe stafin pedagogjik-psikologjik**

Drejtori Hulaj takoi asistentët e punësuar dhe staf profesional, duke u dhënë porosi: “Bëni atë që nuk thuhet, atë që nuk shihet dhe atë që nuk arrihet.” Deçani vazhdon të jetë lider në arsimin gjithëpërfshirës.

- **Shpallja e Konkursit për ndarjen e bursave për studentët deçanas**

Linku i konkursit: [Konkursi 2025](#)

- **Testi PISA**

Testi u zhvillua në IAAP “Tafil Kasumaj” dhe Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” për nxënësit e gjeneratës së vitit 2009. Koordinatorja profesoresha Fatime Kukalaj dhe specialisti IT Remzi Dautaj, së bashku me prof. Ermir Imami, siguronin funksionimin e testit. Drejtori Hulaj uroi sukses nxënësve dhe falënderoi të gjithë të përfshirët.

- **Rezultatet e Olimpiadës Komunale të Matematikës**

Më 13-12-2025, në IAAP “Tafil Kasumaj”, morën pjesë rreth 170 nxënës. Përfaqësuesit e komunës në Olimpiadën Kombëtare më 10-01-2026 në Prishtinë janë:

- **Klasa VII:** Basri Mataj, Sara Çekaj
- **Klasa VIII:** Arsa Tishukaj, Taulant Salihu
- **Klasa IX:** Erion Bozhdaraj, Onida Likaj, Erland Leci
- **Klasa X:** Enkela Zeqiraj, Agon Muçaj
- **Klasa XI:** Andi Osdautaj, Art Qorraj
- **Klasa XII:** Adeonë Rexhaj, Loris Lokaj

- **Memorandum Bashkëpunimi me OJQ “AGIMI”**
Qëllimi është ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe luftimi i dhunës me bazë gjinore përmes promovimit të trashëgimisë kulturore. Projekti përfshin shkollat e Komunës së Deçanit.
- **Takime me Këshillin Pedagogjik, Psikologjik dhe Logopedik**
U diskutua fillimi i procesit të Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve, duke vlerësuar lartë angazhimin e KPPL-së.
- **Bashkëpunimi me KFOR-in Italian vazhdon.**
- **Takim me drejtorët e shkollave**
Diskutuan mbi zhvillimin e procesit arsimor, VPM, trajnime për mësimdhënësit, furnizimin me dru për ngrohje dhe çështje të tjera me rëndësi për procesin arsimor.
- **Takimi vjetor i psikologëve shkollor**
Psikologët znj. Besarta Tahirukaj-Idrizi, znj. Begije Osaj-Januzaj dhe znj. Qëndresa Cacaj-Berisha morën pjesë në takimin e organizuar nga SHPSHK për standardizimin e formularëve të punës.
- **Aktivitete kulturore dhe festime shkollore**
Nxënësit e shkollës fillore “Isa Boletini” organizuan aktivitet për 28 Nëntorin – Ditën e Pavarësisë.
Data 3 Dhjetor – Dita Ndërkombëtare e Personave me Nevoja të Veçanta u shënuar në të gjitha shkollat e komunës.
- **Suksese në gara dhe aktivitete**
Fondi i Kosovës për Efiçencën e Energjisë: Ajlina Selmanaj fitoi vendin e tretë.
Sfida Bebras Kosova 2025: Komuna e Deçanit renditet në vendin e 5-të në nivel vendi.
SHFMU “Maxhun Çekaj” – vendi i dytë në garat e pingpongut në nivel Republikë.
Hendbolli: Gjumnazi “Vëllezërit Frashëri” shpallet kampion për të pestin vit rresht.
- **Bashkëpunime dhe aktivitete profesionale**
Aktivitet për Ditën Botërore të Personave me Nevoja të Veçanta.
Ndërgjegjësim dhe mirënjohje për donatorët dhe studentët meritë.
Tryezë e përbashkët me Institutin Pedagogjik të Kosovës (IPK) për avancimin e performancës së shkollës dhe përmirësimin e mësimnxënies, me pjesëmarrjen e 40 mësimdhënësve dhe zyrtarëve të DKA-së.
- **Prioritetet kryesore**
 - Fushën e mësimnxënies dhe garat e diturisë dhe sportive.
 - Investimet në shkolla dhe dixhitalizimi.
 - Përmirësimi i kushteve të procesit mësimor dhe sigurisë në shkolla.
 - Mbështetja për fëmijët me nevoja të veçanta përmes asistentëve.

Donacionet në Shkollat e Komunës së Deçanit:

1. Donacioni nga KFOR-i Italian

- **Shkolla përfituese:** SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit” dhe IAAP “Tafil Kasumaj”.
- **Pajisjet dhuruara:** Laptop i serisë së fundit, printer, projektor.
- **Qëllimi:** Përmirësimi i procesit mësimor dhe modernizimi i kabinetit të Gjeografisë.
- **Ceremonia:** Të pranishëm ishin Komandanti i KFOR-it Kolonel Gabriel Vacca, Shefi i CIMIC-it 1° LGT Saverio Ruggiero, Drejtori i DKA-së Besnik Hulaj, drejtori i shkollës Agron Selmonaj, mësimdhënësi, nxënësi dhe prindër.
- **Vlerësimi:** Drejtori Hulaj falënderoi KFOR-in për mbështetjen e vazhdueshme në sigurimin dhe zhvillimin e shkollave.

2. Projekti ALLED2

- **Koordinim:** Z. Blerim Haliti, Koordinator për AAP-së.
- **Objektivat:** Dorëzimi i pajisjeve të teknologjisë së fundit, ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe instruktorëve përmes trajnimeve.
- **Përfitues:** 10 IAAP, 3 QAP dhe 2 fakultete të Universitetit të Prishtinës.
- **Vlerësimi:** Projekti ALLED2 konsiderohet një histori suksesi në reformimin e Arsimit Alternativ Profesional (AAP) në Kosovë.

3. Donacion nga Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

- **Shkollat përfituese:**
 - “Jusuf Gërvalla” – Prapaqan
 - “Dëshmorët e Kombit” – Strelc i Ulët
- **Pajisjet dhuruara:** Kompjuterë për kabinete, salla mësimdhënësish, klasa dhe bibliotekë.
- **Faleminderime:** Rektori prof. Dr. Armand Krasniqi, Prorektori prof. Dr. Edmond Beqiri, prof. Erzen Krasniqi.

4. Donacion nga Kolegji Maerlant – Holandë

- **Shkolla përfituese:** Shkolla “Bajram Curri” – Strelc i Epërm
- **Pajisjet dhe materialet dhuruara:** Desktop digjital, TV, laptop, kompjuter, projektor, mikroskopa, tabela magnetike, karrige, tavolina, dhe materiale të tjera shkollore.
- **Kontributi:** Z. Berat Hasan Hasanramaj për mbledhjen e mjeteve; Shoqata "Haki Povataj" (Zvicër) dhe kryetari Ozmon Ukaj për transportin.

5. Vlerësimi dhe Mirënjohjet

- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj dhe Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj nderuan me mirënjohje:

- Institucione dhe organizata vendore e ndërkombëtare
- Shoqata dhe individë me vullnet të mirë
- **Qëllimi:** Vlerësimi i kontributit në mbështetjen e shkollave të komunës.

Në thelb, këto donacione kanë sjellë **pajisje dixhitale, kompjuterë, material mësimor dhe mbështetje për trajnimet e mësimdhënësve**, duke përmirësuar cilësinë e arsimit dhe dixhitalizimin e shkollave në komunën e Deçanit.

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT 2025 – SEKTORI I ARSIMIT

Grantet Qeveritare / Fondi 10 – Sektori i Arsimit, Komuna e Deçanit

Nr.	Programi / Nënprogrami	Kodi ek.i Nënprogramit	Buxheti i Planifikuar (EUR)	Aktuali / Shpenzimet (Janar–Nëntor 2025) (EUR)
I. Administrata e Arsimit (92075)				
1.	Paga dhe shtesa (11)		64,107.11	57,674.47
2.	Mallra dhe shërbime (13)		15,000.00	14,994.58
II. Arsim Fillor (93420)				
1.	Paga dhe shtesa (11)		3,859,729.76	3,675,241.58
2.	Mallra dhe shërbime (13)		105,000.00	104,997.02
3.	Shpenzime komunale (14)		25,000.00	25,000.00
4.	Projekte kapitale (300)		34,216.00	34,216.00
III. Arsim i Mesëm (94620)				
1.	Paga dhe shtesa (11)		942,473.70	834,680.66
2.	Mallra dhe shërbime (13)		56,950.00	56,950.00
3.	Shpenzime komunale (14)		10,000.00	9,999.61

Investimet kapitale

Gjatë muajve janar – dhjetor 2025, Drejtoria e Arsimit ka realizuar këto projekte kapitale:

- Është bërë përrurimi i SHFMU “Lan Selimi” në Lumbardh.
- Ka përfunduar ndërtimi i rrethojës së SHFMU “Ardhmëria” në Beleg.
- Me investimin e Komunës dhe MASHTI-T kanë përfunduar punimet në shkollën “Dëshmorët e Baballoqit” në Baballoq. Në kuadër të projektit janë përfshirë lyerja e brendshme, dyert, ndriçimi i shkollës dhe inventari i administratës.

Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e punëtorive dhe sallës së sporteve në IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan.

➤ **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

Nr.	Përmbajtja – Aktivitetet	Koha	Zbatuesi	Pjesëmarrësit	Miraton
1.	Realizimi i planit vjetor të punës së DBPZHR	Janar – Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR	Kryetari
2.	Përcjellja e fushatës së korrje - shirjeve	Korrik	DBPZHR	DBPZHR	Kryetari
3.	Takime zyrtare me MBPZHR dhe Ministritë të tjera, OQ dhe OJQ	10 Takime	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR dhe ministritë të tjera, OQ dhe OJQ	
4.	Takime me Organizatën për Sera	Gjatë vitit	DBPZHR	DBPZHR	Kryetari
5.	Vlerësimet e dëmeve në bujqësi	Tetor - Dhjetor	Komisioni komunal i dëmeve	Tre Drejtoritë me komisionet e tyre	Kryetari dhe Kuvendi Komunal
6.	Dhënia e Pëlqimit (kërkesa) për shndërrimin e tokës bujqësore ne tokë ndërtimore	Korrik - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR	
7.	Raporti për fushatën e korrje-shirjeve-2024	Gusht	DBPZHR-zyrtari me staf	DPBZHR, MPPZHR, fermerët dhe autokombanjerët	
8.	Përcjellja e kulturave pranverore	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-zyrtari	DPBZHR dhe fermerët	
9.	Grumbullimi i të dhënave, rezultateve të prodhimitarisë bujqësore	Korrik - Nëntor	DBPZHR-zyrtari dhe stafi	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët	Kryetari
10.	Kontakte dhe vizita në fermat prodhuese Mbi 150 vizita te fermat individuale	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-stafi	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët	

11.	Përfundimi i programeve zhvillimore: -Memorandumi MBPZHR – K. Deçan -Përcjellja e realizimit dhe sanimi i pengesave ne realizimin e punimit te kanaleve në ndërtim	Korrik - Dhjetor	DBPZHR dhe stafi	DPBZHR, MPPZHR dhe fermerët	
			Komuna	Komuna	
12.	Trajnime ne Menaxhimin e Integruar	Gjatë gjithë vitit	DBPZHR QIKB	DPBZHR, MPPZHR	
13.	Aktivite te në Qendrën informative Komunale të Bujqësisë • 116 konsulta dhe këshilla për fermer • 18 vizita në teren-pemëtarë • 15 vizita në stalla 5 vizita ne sera	Korrik - Dhjetor	DBPZHR dhe këshilltari	QIK DSHK Këshilltari publik i Shërbimeve Këshillues të Kosovës	MBPZHR
14.	Organizimi i stafit për Pagesat Direkte pas përfundimit te aplikimit Aplikimi për pagesa direkte për aplikim Aplikimi për pagesa direkte për qumësht, plehut artificial, viça për majmëri dhe grurit për KG, ku janë 515 fermer aplikues-Faza e parë	Korrik - Dhjetor	DBPZHR dhe stafi	DPBPZHR-MBPZHR-AZHB-ja	MBPZHR
15.	Ndihma për fermerët aplikues në Grande	Gjate kohës së aplikimit	DBPZHR QIKB		

16.	Ndihmë në organizimin e Ditës së Gështenjës dhe prodhimeve bujqësore	Tetor	DBPZHR &stafi	DBPZHR dhe stafi	Kryetari
17.	Menaxhimi i projektit Mëshqerra: Finalizimi i projektit Vizita tek fermerët përfitues	Korrik - Nëntor	Donatori Kryetari DPBZHR	DBPZHR dhe Donatori	Kryetari
18.	Është përpiluar raporti për mbjellat vjeshtore 2024-25	Gusht - Shtator	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR	
19.	Vizita brenda dhe jashtë Kosovës Shkëmbim i Përvojave	Korrik - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR, MBPZHR	
20.	Trajnime: Në kuadër të projektit : “Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avansimit të shërbimeve Këshillimore të financuar nga MBPZHR dhe implelementuar nga Qendra Kosovare për Zhvillim-KDC	Korrik - Dhjetor	DBPZHR-QKZH-KDC	DBPZHR-QKZH-KDC-MBPZHR	
21.	Organizimi i stafit për aplikimin e fermerëve për Sera	Nëntor - Dhjetor	DBPZHR	DBPZHR dhe Donatori	Kryetari
22.	Numri i lëndëve të shqyrtuara nga drejtoria jonë: - Të pranuar 68 - Në proces 1 - Të refuzuara 3 - Hedhur poshtë 9 - Ceduar 0 - Pezulluar 4	Janar - Dhjetor	DBPZHR-shefi i sektorit	Drejtori	Kryetari

	Anuluar 2				
23.	Shpallja e përfitueseve të Mekanizmit Bujqësor me dy (2) Kontingjent për Fermerët Deçanas	Dhjetor	DBPZHR	Komisioni Komunal për shpalljen e Listës së përfitueseve të mekanizmit bujqësor	Kryetari dhe DBPZHR

➤ Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

- SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë vitit 2025 aktivitetin e vet të planifikuar nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027 , Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarrfikës dhe Shpëtim Nr. 04/-L-049, Udhëzimet Administrative si dhe Aktet tjera normative të cilat e rregullojnë këtë fushë.

Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, konkretisht Sektori për Mbrojtje, Shpëtim ka arritur që t'i kryej punët dhe detyrat e planifikuara rreth parandalimit, evitimit, rekomandimeve të rreziqeve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera etj.

Sektori për Mbrojtje Shpëtim është marr edhe me punë e detyra tjera që dalin nga objektivat dhe planifikimet e drejtorisë në mënyrë periodike ashtu siç janë të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2025.

Raporti vjetor do të përmbajë punët e planifikuara sipas planit vjetor, situatat emergjente, planet të reja të punuara, dokumentet e nevojshme, ku të gjitha këto do të jenë të përpiluara në formë tabelare në baza mujore dhe vjetore:

<u>Nr.</u>	<u>Aktivitetet</u>	<u>Periudha</u>
1.	Përgatitja e planeve të punës, raportit vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2025	Janar
2.	Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara) për Arkivim	Janar
3.	Takimi i I-rë i KKSB-së	Prill

4.	Është intervenuar në objekte të vjetra (kulla) dhe është bërë eliminimi i rrezikut për qytetaret nga shembja dhe rënia e urëve.	Prill - Qershor
5.	Takimi i II-të i KKSB-së	Korrik
6.	Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme nga zyrtarët e sektorit	Gjatë vitit
7.	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike ka pranuar 413 kërkesa në intranet ku 376 janë miratuar, 12 refuzuar, 5 anuluar, 0 pezulluar dhe 19 janë në proces	Janar - Qershor
8.	Mirëmbajtja dhe servisimi i aparateve për shuarjen e zjarrit për të gjitha institucionet publike	Gjatë vitit
9.	Në librin e protokollit të shkurtër janë evidentuar shkresa si: Akte përcjellëse, Autorizime, Ftesa për palët, Njoftime për përfundimin e procedurës ligjore, konkluzionet, kërkesa për plotësim lënde, të cilat punë kanë qenë të pa planifikuara mirëpo janë të domosdoshme gjatë zhvillimit të procedurës ligjore.	Gjatë vitit
10.	Njoftim / apel qytetareve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret. Njoftimi është bërë në forme të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit. Shih linkun: https://www.facebook.com/photo?fbid=997306002405308&set=a.324214523047796	Qershor
11.	Kryerja e punëve administrative: si përgatitja e fletë dorëzimeve, dërgimi i shkresave palëve ne procedurë nëpërmjet shërbimit të postes dhe direkt ne dorë, përgatitja e thirrjeve për palët në procedurë, konsultime me palët ,evidentimi ne regjistrat e inspektimeve e tjera.	Gjatë vitit
12.	Ka vazhduar projekti për mirëmbajtjen dhe zgjerimi i rrjetit të kamerave në qytetin e Deçanit.	Gjatë vitit
13.	Monitorimi, koordinimi dhe mbikëqyrja së bashku me NJPZSH-në rreth zjarreve fushore dhe malore.	Korrik - Gusht

14.	Takimi i III-të i KKSBB-së	Tetor
15.	Dokumenti për vlerësimin e rrezikut në objektet shkollore në Komunën e Deçanit	Gjatë vitit
16.	Takime të rregullta me Policinë, KFOR-in dhe organizata tjera	Gjatë vitit
17.	Komunikim i vazhdueshëm dhe bashkëpunim me QRAKE-Pejë	Gjatë vitit
18.	Takimi i IV-të i KKSBB-së	Dhjetor
19.	Planifikimi i projekteve dhe i buxhetit për vitin 2025 për Sektorin Mbrojtje dhe Shpëtim	Dhjetor
20.	Raport i punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2025	Janar
21.	Përgatitje e planit vjetor të punës për vitin 2026	Janar

REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË INTERVENIMEVE, STRUKTURA E ZJARREVE DHE INT.TJERA PËR 12 mujorin e VITIT 2025													
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i intervenimeve teknike	Aksidente rrugore	Pastrim rruge	Vërshime	Të rrejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
Janar	5	4	1		1								
Shkurt	11	10	1		1								
Mars	32	28	4		4								
Prill	13	11	2	1									
Maj	7	5	2	1									

Qershor	14	11	3	1	1									
Korrik	42	39	3		2									
Gusht	34	29	5	1	1									
Shtator	22	15	7	1	3		1							
Tetor	9	3	6		4									
Nëntor	3		3	1	2									
Dhjetor	5	3	2	1	2									
Gjithsejtë	197	158	39	7	21		1							

KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS 12 MUJORIT TË VITIT 2025

	Lloji I INTERVENIMIT	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	GITHËSEJT
1	ZJARRE	4	10	28	11	5	11	39	29	15	3		3	158
2	INTERVENIME TEKNIK	1	1	4	2	2	3	3	5	7	6	3	2	39
3	SHËRBIME										2	1		
4	AKSIDENTE KOMUNIKACIONI				1	1	1		1	1				
5	VËRSHIME													

6	ALARME TË RREJSHME									1				
1. Llojet e zjarreve;														
1.1	Shtëpi banimi dhe objekte përcjellëse	1	2	1	1		1	1	3	2	2			
1.2	Objekte kolektive (banesa)		1											
1.3	Malore		1	11		1	3	6	2	2				
1.4	Fushore	1	2	13	7		4	28	22	10				
1.5	Stalla te bagëtime					1	1							
1.6	Oxhaqe		1											
1.7	Automjete motorike/vetura		1				1							
1.8	Shtylla elektrike / trafo	1	2	1	2		1		1	1			3	
1.9	Pajisjet shpërndarëse													
1.11	Mbeturina			2	1	2	1	3	1					
1.12	Operator/biznese	1						1			1			
1.13	Institucione publike					1								
	Të tjera				1	1	1			2	4	2		

Ndarja analitike e zjarreve në: SIPËRFAQE TË HAPURA														
4.1		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	GITHËSEJ
	Mal													
4.2	Sipërfaqja e djegur (hektar)		0.70 ha	52.6 ha		0.80 ha	0.50 ha	17 ha		4.5 ha				75.6 Ha
4.3	Fushor													
4.4	Sipërfaqja e djegur (hektar)		12 ha	10.6 ha		5 ha	5 ha	23.4 ha	5.5 ha	3.10 ha				59.6 Ha

Nr.	Detyrat e realizuara	Total	Jana r	Shkur t	Mars	Prill	Ma j	Qersh or	Korri k	Gush t	Shtato r	Teto r	Nënto r	Dhje tor
1.	Zjarret	155	4	10	28	11	5	11	39	29	15	3		3
	Raporte të zjarreve			2	8			1	5	8	2	2		
	Vërtetime te zjarrit				1				1	1	3	1		
2.	Inspektimet e fillestar, rregullta verifikuese					6	5		6			3	3	
	Nr. i te metave dhe mangësive					40	7		40		5	6		

	Insp. në pronësi shtetërore													
	Insp. në pronësi private					5	1							
	Numri i objekteve					5	1				1	3	3	
	Procesverbal				2	5	1				1	3	3	
	Propozim te masave dhe afateve				2	5	1				1	3		
3.	Inspektime te jashtëzakonshme				2						2	1	1	
	Insp. në pronësi shtetërore													
	Insp. në pronësi private				5									
4.	Vendime ne inspektime te rregullta dhe fillestare					5	1				1	3	3	
	Masat e shqiptuara													
5.	Inspektim ne korrje shirjeve dhe maleve								7					
6.	Njoftime							2		1				

- SEKTORI PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për M.SH.SH.P në organizimin e saj udhëhiqet nga Drejtori dhe është e ndarë në dy sektorë: Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Sektori për Shërbime Publike.

Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet, është i organizuar me organogram: Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike, Zyrtar për Ndërtim, Zyrtar për Transportin Publik, Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave, që përveç detyrave të përcaktuara me përkrahimin e vendit të punës, të parapara në nenin 13 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Deçanit, ushtron edhe detyra dhe përgjegjësi të tjera shtesë që dalin nga veprimtaria e drejtorisë, sipas nevojës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas planifikimeve vjetore nga drejtoria, në Sektorin e Shërbimeve Publike, detyra parësore kanë qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik, menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit, mirëmbajtja e varrezave publike si dhe ndërtimi i lapidareve të dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra të tjera dytësore që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve janë edhe punët e përbashkëta që janë me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç është, Kompania N.P.L. "Higjiena", Kompania Regjionale e Ujësjellësit "Hidrodrini", Ndërmarrja Regjionale për Ujitje të tokave "Drini i Bardhë" si dhe bashkëpunimi me KEDS.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve, me theks të veçantë, Sektori i Shërbimeve Publike ka pasur me NPL "Higjiena", ku shumicën e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe Lapidarëve të Dëshmoreve, i ka të kontraktuara me kontratën "Në Shtëpi". I tërë ky aktivitet monitorohet në baza ditore dhe sipas nevojës, nga menaxheri i kontratës dhe zyrtari i lartë për menaxhimin e mbeturinave.

Raporti i punës do të përfshijë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat mbi punët dhe aktivitetet e kryera gjatë vitit raportues, të paraqitura në formë tabelore dhe narrative, në përputhje të plotë me planifikimin e miratuar në vitin paraprak dhe aktet normative në fuqi.

1.Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2025



1.1 Asfaltimi i rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit

Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	Km
	Përfundimi i kontratës për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave - LOT III (Llukë e Ulët, Llukë e Epërme, Dashninoc, Lumbardh, Strelle e Epërme)	28.0 km
	Fillimi i punimeve për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave në qytet dhe fshatrat e komunës - LOT IV	6.3 km

	Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore (Prerja e vegjetacionit në një pjesë të territorit të komunës, sanimi dhe riasfaltimi i gropave në rrugët e komunës së Deçanit, mbushja me zhavorr dhe asfaltimi i një pjese të parkingut tek qendra Rinore, asfaltimi i rrugëve në fshatin Beleg, asfaltimi i rrugëve të lagjes së re tek “Podi i Geshtenjave” në Deçan.	6.6 km
	Vazhdojnë punimet në segmentin Lëbushë-Strelle	
	Fillimi i punimeve në rrugën e Gushavcit	
	Vazhdimi i ndërtimit të trotuareve në Komunën e Deçanit	
	Totali	40.9 km

1.2 Projektet

	Projektet	Projekt i përfunduar/ në vazhdim
	Vazhdojnë punimet në Shtëpinë Alpine "Shkëlzen Haradinaj"	në vazhdim
	Fillimi i punimeve të kanaleve të ujitjes në fshatrat e Komunës së Deçanit	në vazhdim
	Mirëmbajtjes Verore dhe dimërore	në vazhdim
	Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut	në vazhdim
	Ndërtimi i murit mbrojtës të "Ura e Demës"	Përfunduar

Vazhdimi i punimeve ndërtimore në fshatin Turistik, faza e I dhe II-të	në vazhdim
Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Elena Gjika " dhe rrugëve tjera	Një pjesë e projektit ka përfunduar, vazhdon projekti edhe në fshatra tjerë.
Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës Rinore “Fetnete Ramosaj”, N.P.L-së “Higjiena”, “Kolonisë së Artisteve” dhe “Shtëpisë Alpine”	në vazhdim
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Pleqe	në vazhdim
Ndërtimi i rrugës Bjeshka e Madhe (Laku i Kryqës) - faza e II	në vazhdim
Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për fshatin Drenoc	në vazhdim
Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese ,emërtimet e fshatrave, rrugëve etj.	në vazhdim

2. Mirëmbajtja verore dhe dimërore

Rrugët në territorin e Komunës së Deçanit mirëmbahen rregullisht si gjatë sezonit veror ashtu edhe dimëror.

3.Ujësjellësi

Vazhdon bashkëpunimi i ngushtë me Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit K.R.U. "Hidrodrini".

4.Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik

Edhe gjatë vitit 2025, ka vazhduar mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik eficient në tërë territorin e Komunës së Deçanit.

5. Mirëmbajtja e kanalizimit


Komuna e Deçanit në bazë të marrëveshjes respektivisht kontratës me K.R.U “Hidrodrini” si dhe N.P.L. “Higjiena” ka bërë mirëmbajtjen e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhbllokimin e pusetave dhe pastrimi i tyre, zbrazja e gropave septike, gërmimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri në funksionalizimin e plotë të ujërave të zeza.

Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferike. Vendosija e kapakëve metalik dhe të betonit të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike etj.

6. Vendosija dhe mirëmbajtja e tabelave informuese, emërtimet e fshatrave, rrugëve etj

Gjatë pjesës së dytë të vitit 2025 ka filluar vendosja e tabelave të emërtimeve të vendbanimeve, tabelave informuese si dhe mirëmbajtja e tabelave të emërtimeve të rrugëve.

7. Aktivitetet e Komunës bashkë me N.P.L “Higjiena” -Kontrata “Në shtëpi”



Ndër aktivitetet kryesore, Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike, ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” me mbikëqyrjen dhe monitorimin realizimit të punëve të kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Me poshtë do t’i paraqesim punët dhe aktivitetet e kryera në shumë fusha së bashku me N.P.L.”Higjiena” si:

7.1 Mirëmbajtja e hapësirave publike

Komuna e Deçanit në bazë të kontratës me kompanitë e kontraktuara, ka bërë mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe të gjelbra duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobiliesë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, kositja e parqeve, prerja e vegjetacionit, sanimi i gropave dhe riasfaltimi i tyre, si dhe punë me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

7.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

7.3 Mirëmbajtja e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve dhe varrezave publike

Plani për mirëmbajtjen e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mbjellja e barit në parqet e tyre, renovimi i pllakave të dëmtuara, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve, duke përfshirë prerjen dhe kositjen e barit, largimi i mbetjeve mes pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative ka vazhduar në të gjitha fshatrat dhe varrezat në tërë territorin e komunës. Ndërrimin dhe vendosjen: të ulëseve të reja, shportave të mbeturinave si dhe mirëmbajtjen e rrethojave etj.

Mirëmbajtja e varrezave publike në gjithë territorin e komunës së Deçanit.

7.4 Eliminimi i deponive ilegale

Gjatë vitit 2025 është bërë identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave dhe janë marr masat për eliminimin e tyre. Gjithashtu është përgatitur dhe dorëzuar raporti vjetor për Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit AMMK me të gjitha të dhënat e kërkuara.

8. Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së

- Gjatë 2025 është bërë vazhdimi i kontratave me lokalet afariste si dhe janë nënshkruar kontrata të reja me disa lokale për shfrytëzimin e hapësirave publike si dhe në baza të rregullta janë lëshuar faturat. Aktivitetet dhe punët tjera shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrjet në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve (pikave të grumbullimit të mbeturinave), kanaleve të ujitjes, prerja e vegjetacionit etj.
- Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2025
- Planifikimi i projekteve dhe i buxhetit për vitin 2025 për Sektorin Shërbime Publike
- Raport i punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2025
- Përgatitje e planit vjetor të punës për vitin 2026.

9. Pjesëmarrje në punëtori, trajnime

Pjesëmarrje në punëtori, trajnime: (Zyrtari i Lartë për MM):

- 20.02.2025 - Projekti i fizibilitetit për oborret e riciklimit në pesë komunat e rajonit të Dukagjinit - punësoria e II-të, lokacionet e oborreve, skenarët e menaxhimit të mbeturinave, analizat financiare dhe të rentabilitetit, modelit të operimit të qendrës;
- 03.03-07.03.2025 - Akademia e Kosovës për Siguri Publike AKSP-Vushtrri Trajnimi: Bazat e Menaxhimit Emergjent;
- 06.03.2025 - Takimi i dytë online mbi iniciativën WiFi4WB (Wi-Fi për Ballkanin Perëndimor), projekt që është pjesë e iniciativës EU4Digital, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe qeveria gjermane dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ);
- 20.03.2025 - Takimi i përbashkët mes Asociacionit të Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe GIZ-Kosova, projektit Kosovo for Green, procesi i raportimit vjetor, për indikatorët e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave, sipas kërkesës për përmbushjen e obligimit ligjor vjetor;
- 07.04.2025 - Punësoria e IV-të me Kolegjiumin për Ekonomi Qarkore për hartimin e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) në pesë komuna të rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik;
- 28.03.2025 - Dorëzimi/aplikimi për iniciativën WiFi4WB;
- 14-16.04.2025 - Berat – Shqipëri - Punëtori dhe Vizitë Studimore me Kolegjiumin për Ekonomi Qarkore Asociacioni i Komunave të Kosovës në hartimin e Planeve Nder komunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave, në bashkëpunim me GIZ;
- 16.05.2025 - Punësoria e V-të për hartimin e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave(PNMIM) në pesë komuna e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik;
- 22.05.2025 - Punësoria e VI-të, për prezantimin e draftit final të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Planin Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) në pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.;
- 25.06.2025 - Punësoria e III-të në kuadër të projektit të fizibilitetit për ndërtimin e Qendrave për Grumbullim dhe Riciklim të Mbeturinave (Oborreve të Riciklimit) për komunal e rajonit të Dukagjinit.
- 29.07.2025 - Punësoria e VI-të e Planit Ndër-Komunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik, lidhur me draft Marrëveshjen e Bashkëpunimit Ndër-komunal (MBNK) në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave;
- 08 deri më 12.09.2025 - në emër të Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), mbështetur nga GIZ Kosova, projekti Kosovo for Green (K4G), në vazhden e zhvillimit të proceseve të ndërlidhura me Bashkëpunimin Ndërkomunal dhe Planifikimin Strategjik për Menaxhimin e Integruar të mbeturinave, Vizitë Studimore në Slloveni, e shoqëruar nga Pjesëmarrje në Konferencën për Ekonomi Qarkore, [PROGRAMME - Circular Economy Hotspot Slovenia 2025](#). Qëllimi i kësaj vizite studimore është ofrimi i mundësisë për tri regionet në Republikën e Kosovës, Gjilan & Ferizaj, Dukagjini dhe Mitrovica, të cilat janë në procesin e planifikimit të përbashkët për menaxhimin e integruar të mbeturinave, për shkëmbimin e praktikave të suksesshme Sllovene për menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe ekonomin qarkore, zhvillimi i suksesshëm i procesit të Bashkëpunimit Ndërkomunal si dhe proceseve tjera të ndërlidhura me qasjen e menaxhimit të integruar. Vizita studimore e shoqëruar me pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare për Ekonomi Qarkore, Lubjanë. Konferenca do të shërbejë për të marrë përvoja nga shtetet e Bashkimit Evropian mbi zgjidhjet ligjore, teknike dhe operationale si dhe formës së implementimit të Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave dhe finalizimit të Marrëveshjes për Bashkëpunim Ndërkomunal;
- 31.10.2025 “Nga Politika në Praktikë: Ligji për Mbeturinat dhe Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP)”- organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë dhe mbështetur nga GIZ – Kosova (projekti “Kosovo for Green”) punëtori që synon të shërbejë si platformë konsultimi në mes të nivelit qendror dhe lokal, me fokus në temën e menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe

- përfshin Grupin Punues për Ekonomi Qarkore (ZKMM-të) dhe grupin punues ndërmënytor për hartimin e Ligjit për Mbeturina.- Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (ITP), Prizren;
